



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 2.2.2022**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIN PUBLIK TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE**  
**TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 16, pika 4, nenit 21, pika 2 dhe nenit 31, pika 4 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren “Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për krijimin, mirëmbajtjen dhe publikimin e regjistrit publik, si dhe subjektet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje për paraqitjen e informacionit të nevojshëm, për t’u përfshirë në regjistër.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**

## **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i subjekteve dhe të dhënave që do të përmbajë regjistri publik i ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe agjentëve të tyre.

## **Neni 2 Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe “f” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 16, pika 4, nenit 21, pika 2 dhe nenit 31, pika 4 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (i cili, në vijim në këtë rregullore, do të quhet ligji “Për shërbimet e pagesave”).

## **Neni 3 Subjektet e regjistrimit të ofruesve të shërbimeve të pagesave**

1. Banka e Shqipërisë krijon regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave, i cili përmban të dhëna për:
  - a) institucionet e pagesave, sipas përkufizimit të nenit 5, pika 13 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
  - b) institucionet e parasë elektronike;
  - c) ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, sipas përcaktimit të nenit 28 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
  - d) agjentët e subjekteve të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni;
  - e) ofruesit e shërbimeve, që përfitojnë nga përjashtimet, sipas parashikimeve të nenit 4, shkronja “gj”, nënpikat “i” e “ii” të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, në rast se Banka e Shqipërisë merr një vendim për mosvazhdimësinë e përjashtimit nga ligji, në përputhje me kërkesat e nenit 31, pika 2 të këtij ligji;
  - f) ofruesit e shërbimeve, të përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, sipas nenit 4, shkronja “h” të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.

## **Neni 4 Regjistrimi i institucioneve të licencuara dhe agjentëve të tyre**

1. Institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, si dhe agjentët e tyre regjistrohen në një listë të veçantë nga subjektet e tjera të parashikuara në shkronjat “c”, “e” dhe “f” të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
2. Për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të licencuara, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) emrin e subjektit (sipas përcaktimit në licencë);
  - b) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);
  - c) adresën e selisë qendrore të subjektit;
  - d) kapitalin fillestar të paguar;
  - e) identitetin (emrin) e aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe përqindjet e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë;

- f) identitetin e administratorit/ëve dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit;
  - g) numrin dhe datën e licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë;
  - h) adresën e degëve (nëse ka);
  - i) listën e veprimtarive/shërbimeve të lejueshme, që kryen subjekti;
  - j) numrin dhe datën e vendimit për shfuqizimin e licencës nga Banka e Shqipërisë;
  - k) numrin dhe datën e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive, nga Banka e Shqipërisë.
3. Banka e Shqipërisë regjistron të dhënat e përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a” deri në “i” të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e licencimit, si dhe të dhënat mbi shfuqizimin e licencës apo pezullimin e një ose disa veprimtarive, të parashikuara në shkronjat “j” dhe “k” të pikës 2 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit përkatës.
  4. Banka e Shqipërisë, për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në pikën 2, shkronjat “a” deri në “i” të këtij neni, të kryer nga subjekti, përditëson këto të dhëna në regjistrin publik, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.
  5. Për agjentët e institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
    - a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e agjentit;
    - b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe/ose të shërbimeve të parasë elektronike që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;
    - c) shërbimet e pagesave ose shërbimet e parasë elektronike që do të kryejë agjenti.
  6. Banka e Shqipërisë regjistron agjentin dhe të dhënat e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 të nenit 21 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, nga institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike.  
Vetëm pas regjistrimit sipas kësaj pike, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave dhe/ose të shërbimeve të parasë elektronike.

## **Neni 5**

### **Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë**

1. Për ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e ofruesit;
  - b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e subjektit;
  - c) numrin dhe datën e vendimit për regjistrim, të dhënë nga Banka e Shqipërisë;
  - d) adresën e degëve (nëse ka);
  - e) listën e shërbimeve të lejueshme, që kryen subjekti;
  - f) numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik.

2. Banka e Shqipërisë regjistron ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë dhe të dhënat e përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a” deri në “e” të këtij neni, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për regjistrim, siç parashikohet në nenin 50, pika 6 të rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, dhe për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në pikën 1, shkronjat “a” deri në “e” të këtij neni, të kryer nga subjekti, përditëson këto të dhëna në regjistrin publik brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit. Banka e Shqipërisë përfshin në regjistër, numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë nga regjistri publik, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.
3. Për agjentët e ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e agjentit;
  - b) identitetin e administratorit dhe të personave përgjegjës për administrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave që agjenti do të kryejë në emër dhe për llogari të subjektit;
  - c) shërbimet e pagesave që do të kryejë agjenti.

Banka e Shqipërisë regjistron agjentin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë pikë, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes nga ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë, të dokumentacionit të parashikuar në pikën 3 të nenit 54 të rregullores “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”.

Vetëm pas regjistrimit sipas kësaj pike, agjenti mund të fillojë ofrimin e shërbimit të pagesave.

## **Neni 6**

### **Regjistrimi i ofruesve të shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet**

1. Për subjektet e parashikuara në shkronjat “e” dhe “f” të nenit 3 të kësaj rregulloreje, regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) emrin, numrin unik të identifikimit (NUIS) dhe adresën e ofruesit;
  - b) identitetin e administratorit të subjektit;
  - c) numrin dhe datën e vendimit për regjistrim;
  - d) veprimtaritë që kryen subjekti;
  - e) numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik.
2. Banka e Shqipërisë regjistron të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit për regjistrimin në regjistrin publik, si dhe përditëson këto të dhëna brenda 15 ditëve nga data e njoftimit për çdo ndryshim që mund të ndodhë në të dhënat e mësipërme. Banka e Shqipërisë përfshin në regjistër, numrin dhe datën e vendimit për çregjistrimin e subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi.

**Neni 7**  
**Publikimi i regjistrimit të ofruesve të shërbimeve të pagesave**

Regjistri i ofruesve të shërbimeve të pagesave publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe përditësohet e administrohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes.

**Neni 8**  
**Dispozitë kalimtare**

Institucionet e parasë elektronike, të licencuara në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të vazhdojnë të mbeten të regjistruar në regjistrin e subjekteve të licencuara të parashikuar në nenin 128 të këtij ligji, deri në momentin e pajisjes me aneksin e përditësuar të licencës për shërbimet e pagesave që ushtrojnë, siç parashikohet në nenin 99, pika 6 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe më pas do të regjistrohen në regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në këtë rregullore.

**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

**Gent SEJKO**

# ANEKS 1

## **Regjistri i ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike**

| <b><u>Lista e Shërbimeve të pagesave sipas aneksit 1 të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u></b>  |
|--|
| 1. Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.  |
| 2. Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.   |
| 3. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:<br>a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;<br>b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;<br>c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike. |
| 4. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:<br>a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;<br>b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese ose nga një pajisje e ngjashme;<br>c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.  |
| 5. Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimit të transaksioneve të pagesave.  |
| 6. Dërgesat e parave.  |
| 7. Shërbimi i inicimit të pagesës.   |
| 8. Shërbimi i informimit të llogarisë.   |

| <b><u>Lista e shërbimeve, sipas nenit 4, shkronja "g", nënpikat "i" dhe "ii" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u></b>   |
|---|
| gj) Shërbime të bazuara në instrumentet specifike të pagesave që mund të përdoren vetëm në një mënyrë të kufizuar, që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:<br>i. instrumentet që lejojnë mbajtësin të blejë mallra ose shërbime vetëm në vendndodhjet e emetuesit ose brenda një rrjeti të kufizuar të ofruesve të shërbimeve, në bazë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë tregtare me një emetues profesional;<br>ii. instrumentet, të cilat mund të përdoren vetëm për të blerë një numër shumë të kufizuar mallrash ose shërbimesh. |

| <b><u>Lista e shërbimeve, sipas nenit 4, shkronja "h" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"</u></b>   |
|--|
| h) Transaksione të pagesave nga një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose shërbime të ofruara krahas shërbimeve të komunikimeve elektronike për një pajtëtar të rrjetit ose të shërbimit:<br>i. për blerje të shërbimeve digjitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumin e shërbimeve digjitale dhe pasqyruar në faturën përkatëse; ose<br>ii. për të realizuar nga ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike dhe për të pasqyruar në faturën përkatëse, në kuadër të një aktiviteti bamirësie ose për blerjen e biletave. |

Institucionet e pagesave

| Të dhëna mbi subjektin |      |                           |                          |                             |   |   |                 |   |  |  |
|------------------------|------|---------------------------|--------------------------|-----------------------------|---|---|-----------------|---|--|--|
| Emri i subjektit       | NUIS | Numri dhe data e licencës | Adresa e selisë qendrore | Kapitali fillestar i paguar | Emri i aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe % e pjesëmarrjes në kapital | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit | Adresa e degëve | Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime pagesash, sipas Aneksit 1 të ligjit nr.55/2020) | Numri dhe data e vendimit për shfuqizimin e licencës | Numri dhe data e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |   |  |  |

Agjentët e institucioneve të pagesave

| Të dhëna mbi agjentët            |                 |      |                   |  |  |
|----------------------------------|-----------------|------|-------------------|--|--|
| Emri i Institucionit të pagesave | Emri i agjentit | NUIS | Adresa e agjentit | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave | Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti |
|                                  |                 |      |                   |  |  |
|                                  |                 |      |                   |  |  |
|                                  |                 |      |                   |  |  |
|                                  |                 |      |                   |  |  |
|                                  |                 |      |                   |  |  |

Institucionet e parasë elektronike

| Të dhëna mbi subjektin |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|------------------------|------|---------------------------|--------------------------|-----------------------------|---|---|-----------------|--|---|--|--|
| Emri i subjektit       | NUIS | Numri dhe data e licencës | Adresa e selisë qendrore | Kapitali fillestar i paguar | Emri i aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe % e pjesëmarrjes në kapital | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit | Adresa e degëve | Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime të parasë elektronike) | Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen (shërbime pagesash, sipas Aneksit 1 të ligjit nr.55/2020) | Numri dhe data e vendimit për shfuqizimin e licencës | Numri dhe data e vendimit për pezullimin e një ose disa veprimtarive |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |
|                        |      |                           |                          |                             |   |   |                 |  |   |  |  |

Agjentët e institucioneve të parasë elektronike

| Të dhëna mbi agjentët                      |                 |      |                   |  |  |  |
|--|-----------------|------|-------------------|--|--|--|
| Emri i Institucionit të parasë elektronike | Emri i agjentit | NUIS | Adresa e agjentit | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave dhe/ose të parasë elektronike | Lista e shërbimeve të parasë elektronike që do të kryejë agjenti | Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti |
|  |                 |      |                   |  |  |  |
|  |                 |      |                   |  |  |  |
|  |                 |      |                   |  |  |  |
|  |                 |      |                   |  |  |  |



Ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë

| Të dhëna mbi subjektin |      |  |                          |   |                 |   |  |
|------------------------|------|--|--------------------------|---|-----------------|---|--|
| Emri i subjektit       | NUIS | Numri dhe data e vendimit për regjistrim | Adresa e selisë qendrore | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e subjektit | Adresa e degëve | Lista e shërbimeve të lejueshme që subjekti kryen | Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |
|                        |      |  |                          |   |                 |   |  |

Agjentët e ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë

| Të dhëna mbi agjentët                                   |                 |      |                   |  |  |
|---|-----------------|------|-------------------|--|--|
| Emri i ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë | Emri i agjentit | NUIS | Adresa e agjentit | Emri i administratorit dhe personave përgjegjës për administrimin e shërbimeve të pagesave | Lista e shërbimeve të pagesave që do të kryejë agjenti |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |
|   |                 |      |                   |  |  |

Ofruesit e shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet, sipas nenit 4, shkronja "gj", nënpikat "i" dhe "ii" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"

| Të dhëna mbi subjektin |      |  |                          |                                     |                               |  |
|------------------------|------|--|--------------------------|-------------------------------------|-------------------------------|--|
| Emri i subjektit       | NUIS | Numri dhe data e vendimit për regjistrim | Adresa e selisë qendrore | Emri i administratorit të subjektit | Veprimtaritë që kryen ofruesi | Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |

Ofruesit e shërbimeve që përfitojnë nga përjashtimet, sipas nenit 4, shkronja "h" të ligjit "Për shërbimet e pagesave"

| Të dhëna mbi subjektin |      |  |                          |                                     |                               |  |
|------------------------|------|--|--------------------------|-------------------------------------|-------------------------------|--|
| Emri i subjektit       | NUIS | Numri dhe data e vendimit për regjistrim | Adresa e selisë qendrore | Emri i administratorit të subjektit | Veprimtaritë që kryen ofruesi | Numri dhe data e vendimit për çregjistrimin e subjektit nga regjistri publik |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |
|                        |      |  |                          |                                     |                               |  |